

**Kandidate për Këshillin e Lartë të Prokurorisë**

**Prokurore Elona Alvora**

# PLATFORMË

## ARSYET PËR TË MARRË PJESE NË MBLEDHJE DHE PËR TË VOTUAR

Përpara zbatimit të reformës legislative të vitit 2016, ishin krijuar procedura jotransparente në lidhje me vendimet e emërimit, transferimit, promovimit dhe disiplinimit të prokurorëve. Konstatohet mungesa e një procedure standarte vlerësimi që shoqërohet me mungesë të kritereve specifike dhe objektive të matjes së aftësive, profesionalizmit dhe integritetit. Praktikisht meritokracia dhe profesionalizmi nuk ishin rrugët e inkurajara për t'u ndjekur për zhvillimin e karrierës.

Me konstituimin e KLP-së në dhjetor të vitit 2018 e në vijim, situata nuk ndryshoi me rritimin e kërkuar, në drejtim të rritjes së transparencës dhe të ndërtimit të mekanizmave efikas. Problematikat aktuale janë krijuar jo vetëm për shkak të largimeve të prokurorëve nga sistemi, por edhe nga vonesat në miratimin e rregulloreve lidhur me karrierën dhe lëvizjen e prokurorëve që kanë vite që kontribuojnë në sistem, si dhe mospërcaktimin e standarteve konkrete paraprahe për vlerësimin e prokurorëve mbi të cilat të ndërtohet mekanizmi i llogaridhënies dhe përgjegjshmërisë (ende promovimi i prokurorëve, përfshi edhe kandidimin tim në këtë garë, bëhet mbi bazën e vlerësimeve të bëra nga Prokurori i Përgjithshëm).

## ARSYET E PJESËMARRJES NË GARË

Të jap kontributin tim për ndryshimin e kulturës organizative. Rregullat kanë ndryshuar për të vendosur praktika të reja dhe jo për t'i interpretuar rregullat e reja në mënyrë që praktikave të mëparshme të mbeten të pandryshueshme. Mosndryshimi i praktikave bën që të mos vijnë rezultatet e pritura nga reforma në drejtësi për shkak të vijimit të ekzistencës së arsyeve për të cilat është kryer edhe reforma në drejtësi.

Të vendos eksperiencën time profesionale në dispozicion të prokurorëve për t'u bërë pjesë e strategjisë së KLP për të garantuar pavarësinë, përgjegjshmërinë, transparencën dhe efikasitetin e vendimmarrjes së organeve të qeverisjes së sistemit prokurorial (mbi bazën e zhvillimit të karrierës së prokurorëve të bëhet mbi baza meritokracie dhe integriteti).

Të jem aktive në sigurimin e pavarësinë së prokurorisë (duke përfshirë këtu edhe pavarësinë e brendshme të prokurorëve të çështjeve) që do të garantonte:

- a) Rritjen e pavarësisë së gjyqësorit;
- b) Rritje të statusit, përgjegjshmërinë, llogaridhënien dhe paanësinë e prokurorëve.

## VIZIONI IM PËR KLP

Krijimi i një sistemi prokurorial shqiptar, i cili zhvillon një strategji të qëndrueshme në menaxhimin e burimeve njerëzore (prokurorëve) duke krijuar për secilin prej tyre:

a) mundësi të barabarta zhvillimi profesional;

b) vlerësim profesional të aftësive dhe zotësive të gjithësecilit mbi bazën e standarteve të përcaktuara paraprakisht.

Krijimi i mundësive të barabarta të zhvillimit profesional dhe përcaktimi i standarteve paraprake të vlerësimit do të krijojë një sistem meritokratik zhvillimi profesional (karriera në sistemin prokurorial përbëhet në thelb nga këto nivele: menaxhimi i çështjeve, menaxhimi i zyrave prokuroriale dhe ndërtimi i një vizioni për sistemin prokurorial gjatë ndërveprimit me sisteme të tjera).

Zhvillimin e mundësive të barabarta për çdo prokuror/prokurore në secilin nivel të karrierës dhe krijimi i modelit meritokratik të zhvillimit të karrierës së prokurorëve do të sjellë krijimin e një sistemi prokurorial të besueshëm, të drejtë, të pavarur, profesional dhe të orientuar drejt shërbimit (vendosja e standarteve konkrete të këtij shërbimi lidhet me kriteret objektive, specifike dhe konkrete të vlerësimit profesional të prokurorëve që duhet t'u bëhen paraprakisht të ditura prokurorëve), transparent në veprimtarinë e tij sipas ligjit, të përgjegjshëm dhe efikas.



## FOKUSI DHE PËRPIEKJET E MIA GJATË MANDATIT TIM

Krijimi i vizioneve bashkëkohore (zhvendosja nga nocioni i “zyrave të kuadrit” në nocionin e “zhvillimit strategjik të burimeve njerëzore”) dhe ndërmarrja e veprimeve konkrete për ndryshimin e praktikave të mëparshme në menaxhimin e burimeve njerëzore (prokurorëve).

Prokurorët vlerësohen mbi të njëjtat kritere dhe jo mbi kritere të ndryshme. P.sh. për shkak të shproporcionit në çështje prokurorët e çështjeve të një prokurorie të vlerësohen se si kanë performuar edhe për çështjet që duhet t’i kishin pasur koleget e munguar në detyrë për arsye të ndryshme, ndërkohë që prokurorët e çështjes së një prokurorie tjetër të vlerësohen thjesht për paraqitjen në punë pasi nuk kanë pasur ngarkesë në çështje.

Mirëfunksionimi i strukturës sipas pritshmërive të legjislatorit dhe publikut.

Krijimi për grupet e interesit (prokurorët dhe subjekteve të tjera pjesë e sistemit të prokurorisë në R.SH) I mundësive të barabarta në zhvillimin karrierës dhe trajtim të barabartë (shmangie të kulturalizimit për aq sa është e mundur).

## PROKURORËT, ASET I RËNDËSISHËM I SISTEMIT TË DREJTËSISË

Në rast se zgjidhem anëtare e KLP-së, kontributi im do të përqëndrohet në:

Miratimin e akteve normative me karakter të përgjithshëm detyruar mbi të gjithë prokurorët. Në mënyrë të veçantë duhet të përcaktohen standarte vlerësimi profesional të prokurorëve konkrete dhe të bazuara në gjendjen aktuale dhe jo gjendjet ideale që do të duhej të ishte prokuroria. Në këtë mënyrë do të kalohej nga një sistem menaxhimi burimesh njerëzore që i krahason prokurorët me njëri-tjetrin mbi baza rajonale në një sistem menaxhimi zhvillimi profesional ku performanca e çdo prokurori krahasohet me standartet e përcaktuara paraprakisht, që janë të lidhura me kriteret e vlerësimit të shërbimit prokurorial që i ofrohet publikut;

Forcimin e statusit të magjistratit nga vetë KLP dhe jo garantimi i tij përmes gjykatës (nëse publiku është përfituesi i shërbimit prokurorial, prokurorët janë përfituesit e shërbimit të ofruar nga KLP).

Miratimin dhe ndryshimin e akteve për rregullimin e procedurave të brendshme të KLP me fokus të veçantë rritjen e transparencës në nivel komisioni (mungesa e transparencës në nivel komisioni është kritikuar në raportet e shoqërisë civile);

Miratimin apo ndryshimin e rregullave për funksionimin e administratës së Këshillit. Rritjen e efikasitetit të shërbimit dhe krijimin e mundësive të barabarta të zhvillimit profesional në administratën e KLP-së;

## VIJON

Miratimin e rregullave të detajuara mbi menaxhimin dhe përdorimin e teknologjisë së informacionit nga institucionet e sistemit të prokurorisë në bashkëpunim me qendrën e teknologjisë së informacionit për sistemin e drejtësisë (kjo situatë merr rëndësi të veçantë pas situatës së krijuar në vend nga COVID 19) dhe nxitjen e praktikave që marrin në konsideratë përdorimin e teknologjisë. Marrja në konsideratë e faktit për pajisjen e të gjithë prokurorëve në detyrë me nënshkrim elektronik dhe aplikimin e tij në aktet që nxjerrin gjatë punës së tyre.

Hartimin, miratimin dhe zbatimin e planit strategjik për sistemin e prokurorisë me vizionin dhe misionin e KLP, si dhe në koordinim me strategjinë e sektorit të drejtësisë.

Bashkëpunim me Kryetarin e KLP për mirëfunksionimin e strukturës së administratës së Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Përmbushjen e detyrave të parashikuara nga ligji si pjesëtar i trupës kolegjiale apo detyrave individuale të caktuara nga Këshilli.

## PËRSE DUHET TË MË VOTONI?

Sepse në KLP ka nevojë për njerëz të fokusuar (t'i kenë të qarta idetë e tyre) dhe të përqëndruar (të kenë vullnet për t'i çuar gjërat që kanë marrë përsipër deri në fund). Unë jam njëkohësisht e fokusuar (idetë janë ato të paraqitura në këtë platformë) dhe e përqëndruar bazuar kjo në aftësitë personale dhe profesionale, në eksperiencën shumëvjeçare të pandërprerë në sistemin e prokurorisë, si dhe integritetin personal dhe profesional.

Pjesëmarrja ime në këto zgjedhje bazohet në respektimin e të drejtës së votës së secilit prokuror dhe në respektimin e vendimmarrjes së Mbledhjes së Pergjithshme të prokurorëve (të kandidatit që do të dalë fitues dhe që do të plotësojë vakancën e krijuar në KLP si pasojë e shkarkimit të anëtarit të mëparshëm gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar të figurës së tij).

Duhet të kontriboni për suksesin dhe jo ta uroni atë.

Ju faleminderit!

Elona Alvora





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË VLORË

Vlorë, më datë 02.09.2021

**DEKLARATË**

Në referim të kushtit ligjor të parashikuar në nenin 105 të ligjit nr 115/2016 të përditësuar

Unë Elona Alvora, prokurore në prokuroritë e shkallëve të para nga data 12.10.2009 e në vijim, aktualisht në funksionin e prokurores në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, në referim të kërkesave ligjore të parashikuar në nenin 105 të ligjit nr 115/2016 të përditësuar, të materializuar në njoftimin e datës 22.07.2021, të titulluar “Njoftim për hapjen e procedurës së aplikimit të kandidatëve për anëtar të Këshillit të Lartë të Prokurorisë”, bërë përmes postës elektronike zyrtare në domainin pp.gov.al, duke qenë se kam vendosur t’i përgjigjem thirrjes për t’u bërë pjesë e konkurimit,

**DEKLAROJ NËN PËRGJEGJËSINË TIME LIGJORE SE:**

- nuk jam bashkëpunëtore, informatore apo agjente e shërbimeve sekrete;
- nuk kam qenë anëtare, bashkëpunëtore apo e favorizuar nga ish-Sigurimi i Shtetit para 02 Korrik 1991 në kuptimin e ligjit “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore të Shqipërisë” (ky fakt rrjedh edhe koha ime e lindjes që është 11.01.1984).

Gjithashtu, me anë të kësaj shkrese ju jap çdo autorizim të nevojshëm institucioneve për të bërë verifikimin e saj.

**PROKURORE  
ELONA ALVORA**